

Data __.__.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shpenzime për Mirembajtjen e Sistemeve të Parkimit”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbimet e parkimit, 98351100-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 240 000 (tre milion e dyqind e dyzet mijë) **lekë pa Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Tirana Parking ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbytjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të

vlerës së përlogaritur të kontratës

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë me një vlerë jo më të vogël në 20 % të vlerës së fondit limit.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285 e 2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **Çertifikatën ISO 9001:2015** ose ekuivalent, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.” dhe pika 1, neni 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti, enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Për vete natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë shërbimin dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Kriteri i mësipërm për paraqitjen e certifikatës ISO është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesi një vërtetim të lëshuar nga organet përkatëse (Drejtoria Rajonale Tatimore) për numrin e punonjësve të siguruar minimalisht për 6 (gjashtë) muajt e fundit, i cili duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se **5 (pesë) punonjës** ku të jenë të përfshirë dhe stafi profesional, e shoqëruar dhe me listëpagesat (formulari E-SIG 025) për periudhën e sipër përmendur.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar në stafin profesional, minimalisht **3 (tre) punonjës** të trajnuar për mirëmbajtjen e sistemeve të parkimit të listuara në specifikimet teknike. Për plotësimin e kësaj kërkeje ofertuesit duhet të paraqesin certifikatën e trajnimit, CV dhe kontratën e punës të vlefshme për të gjithë periudhën e kryerjes së shërbimit të kërkuar.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues

për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi për mirëmbajtjen e sistemeve të parkimit, objekt prokurimi, ku autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë origjinal i përkthyer dhe/ose fotokopje e noterizuar.

2.3.6 Ofertuesi duhet të paraqesë mirëmbajtjen preventive për secilën lloj pajisje sipas manualeve të përcaktuara nga prodhuesi, të përkthyer, të fotokopjuara dhe noterizuara ku të jetë përcaktuar procedura e kontrollit, pjesët që do të ndërrohen dhe shpeshtësia, intervalet kohore kur është përcaktuar të bëhet mirëmbajtja.

Paraqitja e mirëmbajtjes preventive nuk nënkupton vënien në dispozicion të manualit të servisit por vënien në dispozicion të shërbimeve që do të kryhen sipas përcaktimit që i bën prodhuesi llojit të mirëmbajtjes preventive e cila zakonisht paraqitet në manualin e prodhuesit nëpërmjet llojeve të kontrolleve që kryhen, pjesët e këmbimit që duhet të ndërrohen, shpeshtësinë e kontrolleve etj.

Argumentimi: Autorizimi i Prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin të AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standartet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me Nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar)

1. Mirëmbajtje preventivuese (parandaluese)

KASA MANUALE

1. Pastrim i përgjithshëm
 - a. Pastrim i printerit dhe verifikimi i gjendjes së materialeve të konsumueshme.
 - b. Pastrim i të gjithë përbërësve me ajër të kompresuar.
1. Verifikim i printerit të biletës me barkode.
 - a. Kalibrim dhe centrim i printerit të biletës me barkode.
 - b. Zëvendësim i kokës djegëse të biletës në rast konumimi.
2. Verifikim i leximit të barkodeve 1D dhe 2D
 - a. Realizim i veprimeve dhe testime të njohjes së barkodeve dhe verifikimi që leximi i këtyre të fundit të jetë i saktë. Nëse është e nevojshme, të rregullohet lexuesi.
 - b. Verifikim i mirëfunksionimit të sensorit të prezencës së biletës.
3. Verifikim i funksionimit të UPS.
 - a. Testim i UPS duke e hequr nga karikimi me energji elektrike dhe verifikim nëse ky i fundit i përgjigjet ndërprejes së rrymës. Në rast difekti të zëvendësohet pjesa e dëmtuar.
4. Verifikim i sensorit të afërsisë.
5. Verifikim i terminalit POS.
6. Verifikim i komponenteve me tregues ndriçimi, ekrani.
 - a. Verifikim i mirëfunksionimit të të gjithë komponenteve me tregues ndriçim dhe riparimi i tyre në rast defekti ose keqfunksionimi të bëhen zëvendësimet dhe riparimet përkatëse.

TERMINALI I HYRJES

1. Pastrim i përgjithshëm.
 - a. Pastrim i printerit dhe verifikimi i gjendjes së materialeve të konsumueshme.
 - b. Pastrim i të gjithë përbërësve me ajër të kompresuar.
2. Verifikimi i printuesit, të prerjes së biletës dhe të mekanizmit të nxjerrës se saj.
 - a. Verifikimi i printuesit, i prerjes dhe sistemin e tërheqjes së printerit, duke provuar me bileta prove.
 - b. Verifikim i mirëfunksionimit të sensorit të prezencës së biletës.
3. Verifikim i indikatorëve (ekranit dhe pulsanteve)

- a. Verifikimi i mirëfunksionimit të ekranit dhe të pulsantëve të cilat nxjerrin biletën dhe të interfonisë.
4. Verifikim i sensorit të afërsisë.
5. Verifikim i terminalit POS.
6. Verifikim i interfonisë.
 - a. Verifikim i butonit të interfonisë dhe komunikimit të saj.
7. Verifikim i sensorit të prezencës së makinave.
 - a. Verifikim i komponentëve të sensorit të prezencës së makinave.
 - b. Në rast defekti ose keqfunksionimi, të riparohen dhe zëvendësohen pjesët përkatëse.
8. Zëvendësimi i kavove të ndërlidhjes.
 - a. Zëvendësim i kavove të cilet prej përdorimit dhe vjetërsisë nuk kryejnë si duhet funksionin e tyre.

TERMINALI I DALJES

1. Pastrim i përgjithshëm.
 - a. Pastrim i printerit dhe verifikimi i gjendjes së materialeve të konsumueshme.
 - b. Pastrim i të gjithë përbërësve me ajër të kompresuar.
2. Verifikimi i printuesit, të prerjes së biletës dhe të mekanizmit të nxjerrës së saj.
 - a. Verifikimi i printuesit, i prerjes dhe sistemin e tërheqjes së printerit, duke provuar me bileta prove.
 - b. Verifikim i mirëfunksionimit të sensorit të prezencës së biletës.
3. Verifikim i indikatorëve (ekranit dhe pulsanteve)
 - a. Verifikimi i mirëfunksionimit të ekranit dhe të pulsantëve të cilat nxjerrin biletën dhe të interfonisë.
4. Verifikim i sensorit të afërsisë.
5. Verifikim i terminalit POS.
6. Verifikim i interfonisë.
 - a. Verifikim i butonit të interfonisë dhe komunikimit të saj.
7. Verifikim i lexuesit lazer të biletave elektronike me barkode 1D ose 2D.
 - a. Verifikim i funksionimit të lexuesit lazer të biletave elektronike me barkode 1D ose 2D, dhe në rast keqfunksionimi të bëhet riparimi përkatës dhe zëvendësimi i pjesëve të konsumueshme.
 - b. Pastrimi i komponentëve të lexuesit lazer me materiale speciale pastrimi.
8. Verifikim i sensorit të prezencës së makinave.
 - a. Verifikim i komponentëve të sensorit të prezencës së makinave.
 - b. Në rast defekti ose keqfunksionimi, të riparohen dhe zëvendësohen pjesët përkatëse.

9. Zëvendësimi i kavove të ndërlidhjes.
 - a. Zëvendësim i kavove të cilët prej përdorimit dhe vjetërsisë nuk kryejnë si duhet funksionin e tyre.

BARRIERAT

1. Grasatim i pjesëve të lëvizshme.
 - a. Grasatim i të gjithë pjesëve të cilat u nënshtrohen forcave të ferkimit (bjellat, kushinetat, sustat)
2. Rregullimi i krahut të barrierës dhe kalibrim i tij.
 - a. Verifikim i uljes së ngritjes korrekte dhe të njëtrajtshme të traut dhe në rast defekti ose keqfunksionimi, rikalibrim, riparim dhe zëvendësimi i pjesëve të konsumuara.
3. Verifikimi i pjesëve elektrike dhe baterisë së barrierës dhe sistemit të karikimit.
 - a. Verifikim i tensionit të baterisë dhe sistemit të karikimit.
4. Zëvendësimi i kavove të ndërlidhjes.
 - a. Zëvendësim i kavove të cilët prej përdorimit dhe vjetërsisë nuk kryejnë si duhet funksionin e tyre

SERVERI

1. Verifikimi i komunikimit të të gjithë pajisjeve me serverin.
2. Verifikimi i software të parkimit dhe në rast se ka nevojë për përditësime ose në rast problemesh të kryhen riparimet përkatëse.
3. Verifikimi i rrjetit të brendshëm që lidh serverin me të gjitha pajisjet e tjera, dhe në rast vjetërimi të rrjetit, zëvendësimi i tij.
4. Verifikimi i backup të bazës së të dhënave dhe raporteve financiare, të levizjes, të alarmeve etj.

TABELAT TREGUESE TË VENDEVE TË LIRA

1. Verifikimi i mirëfunksionimit të panelit tregues të vendeve të lira.
 - a. Zëvendësimi i elementëve LED në rast djegieje të tyre.

SISTEMI I LEXIMIT TË TARGAVE

1. Pastrim i përgjithshëm.

- a. Pastrim i brendshëm i pjesëve të sistemit të leximit të targës dhe nëse është e nevojshme, pastrimi i objektivit të kamerës dhe xhamit mbrojtës me mjete speciale pastrimi.
2. Verifikim i mirëfunksionimit të leximit të targave.
 - a. Verifikim i mirëfunksionimit të leximit të targave dhe në rast defekti të kryhen riparimet përkatëse.

PISTONAT OLIODINAMIK

1. Verifikim i funksionimit dhe mirëmbajtje e pistonave oliodinamikë.
2. Verifikim i funksionimit të pulteve të kontrollit në distancë dhe në rast defekti të bëhen riparimet përkatëse.

KASAT AUTOMATIKE

1. Pastrim i përgjithshëm.
 - a. Pastrim i brendshëm i pjesëve të kasës automatike dhe nëse është e nevojshme, pastrimi i moduleve shpërndarëse të monedhave dhe kartmonedhave me mjete speciale pastrimi.
2. Verifikim i mirëfunksionimit të kasës automatike.
 - a. Verifikim i mirëfunksionimit të leximit të targave dhe në rast defekti të kryhen riparimet përkatëse.
3. Verifikimi i printuesit, të prerjes së biletës dhe të mekanizmit të nxjerrës së saj.
 - a. Verifikimi i printuesit, i prerjes dhe sistemin e tërheqjes së printerit, duke provuar me bileta prove.
 - b. Verifikim i mirëfunksionimit të sensorit të prezencës së biletës.
4. Verifikim i indikatorëve (ekranit dhe pulsanteve)
 - a. Verifikimi i mirëfunksionimit të ekranit dhe të pulsantëve.
5. Verifikim i sensorëve të monedhave dhe kartmonedhave.

2. Mirëmbajtje emergjence

Gjithashtu përpos shërbimeve të mirëmbajtjes preventivuese kërkohet dhe shërbim asistence teknike në raste difektesh të paparashikuara nga institucioni, si më poshtë:

1. Asistencë teknike online përmes mënyrës “remote access”, 30 minuta nga njoftimi i defektit në sheshparkim ose në terminal.
2. Asistencë teknike on-site (në terren) brenda 180 minutave në rastin e difekteve të vogla që nuk kërkojnë zëvendësim pjesësh të sistemit të parkimit
3. Asistencë teknike on-site (në terren) brenda 24 orëve në rastin e difekteve të cilat kërkojnë zëvendësim komponentësh të sistemit të parkimit.

Më poshtë gjenden tabelat e periodicitetit të veprimeve dhe shërbimeve të mirëmbajtjes:

- M – Mujore
- T – Tremujore
- G – Gjashtemujore
- V – Vjetore

Kasa Manuale	M	T	G	V
1.Pastrim i pergjithshem	√			
2.Verifikim i printerit te biletes me barkode	√			
3.Verifikim i leximit te barkodeve 1D dhe 2D	√			
4.Verifikim i funksionimit te UPS	√			
5.Verifikim i sensorit te afersise	√			
6.Verifikim i terminalit POS.	√			
7. Verifikim i komponenteve me tregues ndricimi, ekrani	√			

Terminali i Hyrjes	M	T	G	V
1.Pastrim i pergjithshem	√			
2.Verifikimi i printuesit, te prerjes se biletes dhe te mekanizmit te nxjerres se saj.	√	√		
3.Verifikimi i indikatoreve (ekranit dhe pulsanteve)	√			
4.Verifikim i sensorit te afersise	√			
5.Verifikim i terminalit POS	√			
6.Verifikim i interfonise	√			
7.Verifikim i sensorit te prezences se makinave	√			
8.Zevendesimi i kavove te nderlidhjes.			√	

Terminali i Daljes	M	T	G	V
1.Pastrim i pergjithshem	√			
2.Verifikimi i printuesit, te prerjes se biletes dhe te mekanizmit te nxjerres se saj.	√			
3.Verifikimi i indikatoreve (ekranit dhe pulsanteve)	√			
4.Verifikim i sensorit te afersise	√			
5.Verifikim i terminalit POS	√			
6.Verifikim i interfonise	√			
7. Verifikim i lexuesit lazer te biletave elektronike me barkode 1D ose 2D.	√			
8. Verifikim i sensorit te prezences se makinave	√			
9.Zevendesimi i kavove te nderlidhjes.			√	

Barrierat	M	T	G	V
1. Grasatim i pjeseve te levizshme			√	
2.Rregullimi i krahut te barriers dhe kalibrim i tij.		√		
3. Verifikimi i pjeseve elektrike dhe baterise se barrieres dhe sistemit te karikimit.		√		
4. Zevendesimi i kavove te nderlidhjes.			√	

Serveri	M	T	G	V
1. Verifikimi i komunikimit te te gjitha pajisjeve me serverin	√			
2. Verifikimi i software te parkimit dhe ne rast se ka nevojë për perditësime ose në rast problemesh të kryhen riparimet përkatëse		√		
3. Verifikimi i rrjetit te brendshem qe lidh serverin me te gjitha pajisjet e tjera	√			
4. Verifikimi i backup te bazes se te dhenave dhe raporteve financiare, te levizjes, te alarmeve etj.	√			
Tabela treguese e vendeve te lira	M	T	G	V
1.Verifikimi i mirefunksionimit te panelit tregues te vendeve te lira.		√		

Sistemi i leximit te targave	M	T	G	V
1. Pastrim i pergjithshem	√			
2. Verifikim i mirefunksionimit te leximit te targave	√			

Pistonat Oliodinamike	M	T	G	V
1. Verifikim i funksionimit dhe mirembajtje e pistonave oliodinamike.		√		
2. Verifikim i funksionimit te pulteve te kontrollit ne distance	√			

Kasa Automatike	M	T	G	V
1.Pastrim i pergjithshem	√			
2.Verifikimi i printuesit, te prerjes se biletës dhe te mekanizmit te nxjerrës se saj.	√			
3.Verifikimi i indikatoreve (ekranit dhe pulsanteve)	√			
4.Verifikim i sensorit te afersise	√			
5. Verifikim i mirëfunksionimit të kasës automatike.	√			
6. Verifikim i sensorëve të monedhave dhe kartmonedhave.	√			
7. Verifikim i lexuesit lazer te biletave elektronike me barkode 1D ose 2D.	√			
8. Verifikim i sensorit te prezences se makinave	√			
9. Zevendesimi i kavove te nderlidhjes.			√	

Më poshtë janë paraqitur pjesët përbërëse të cilat kanë nevojë për shërbimin e mirëmbajtjes sipas shesheve dhe terminaleve nën administrimin e Tirana Parking:

1. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (pranë Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”).
2. Terminali i Autobuzave Ndërkombëtarë - (pranë Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”).

Nr.	Emri i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Njesia	Sasia	Viti i instalimit
1	Kasa Manuale	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2016
2	Terminali Hyrjes	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2016
3	Terminali i Daljes	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2016
4	Barrierat	Came/Parkare	PRK-CA	Copë	4	2016
5	Serveri	Came/Parkare	DELL	Copë	2	2016
6	Tabela Treguese e vendeve	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2016
7	Sistemi i leximit te targave	Came/Parkare	QUERCUS	Copë	4	2016
8	Pistonat Oliodinamike	Fadini	TALOS	Copë	7	2016

1. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Skënderbej”).

Nr.	Emri i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Njesia	Sasia	Viti i instalimit
1	Kasa Manuale	Came/Parkare	PKE	Copë	1	2017
2	Terminali Hyrjes	Came/Parkare	PKE	Copë	1	2017
3	Terminali i Daljes	Came/Parkare	PKE	Copë	1	2017
4	Barrierat	Came/Parkare	PRK-CA	Copë	2	2017
5	Serveri	Came/Parkare	DELL	Copë	1	2017
6	Tabela Treguese e vendeve	Came/Parkare	PKE	Copë	1	2017
7	Sistemi i leximit te targave	Came/Parkare	QUERCUS	Copë	2	2017
8	Kasa Automatike	Came/Parkare	Came/Parkare	Copë	1	2022

1. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (“Diga e Liqenit”).
2. Terminali i Autobuzave të Jugut dhe Veriut – (“Kompleksi Malajzian”).

Nr.	Emri i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Njesia	Sasia	Viti i instalimit
1	Kasa Manuale	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2018
2	Terminali Hyrjes	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2018
3	Terminali i Daljes	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2018
4	Barrierat	Came/Parkare	PRK-CA	Copë	4	2018
5	Serveri	Came/Parkare	DELL	Copë	2	2018

6	Tabela Treguese e vendeve	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2018
7	Sistemi i leximit te targave	Came/Parkare	QUERCUS	Copë	4	2018

1. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “7 Xhuxhat”).

Nr.	Emri i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Njesia	Sasia	Viti i instalimit
1	Kasa Manuale	Came/Parkare	PKE	Copë	1	2019
2	Terminali Hyrjes	Came/Parkare	PKE	Copë	1	2019
3	Terminali i Daljes	Came/Parkare	PKE	Copë	1	2019
4	Barrierat	Came/Parkare	PRK-CA	Copë	2	2019
5	Serveri	Came/Parkare	DELL	Copë	1	2019
6	Tabela Treguese e vendeve	Came/Parkare	PKE	Copë	1	2019
7	Sistemi i leximit te targave	Came/Parkare	QUERCUS	Copë	2	2019
8	Kasa Automatike	Came/Parkare	Came/Parkare	Copë	2	2022

1. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Italia”).

2. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Selman Stermasi”).

Nr.	Emri i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Njesia	Sasia	Viti i instalimit
1	Kasa Manuale	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2020
2	Terminali Hyrjes	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2020
3	Terminali i Daljes	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2020
4	Barrierat	Came/Parkare	PRK-CA	Copë	4	2020
5	Serveri	Came/Parkare	DELL	Copë	2	2020
6	Tabela Treguese e vendeve	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2020
7	Sistemi i leximit te targave	Came/Parkare	QUERCUS	Copë	4	2020

1. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (“Bulevardi i Ri”).

2. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (“Kopshti Zoologjik”).

Nr.	Emri i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Njesia	Sasia	Viti i instalimit
1	Kasa Manuale	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2022
2	Terminali Hyrjes	Came/Parkare	PKE	Copë	3	2022
3	Terminali i Daljes	Came/Parkare	PKE	Copë	3	2022
4	Barrierat	Came/Parkare	PRK-CA	Copë	6	2022
5	Serveri	Came/Parkare	DELL	Copë	2	2022
6	Tabela Treguese e vendeve	Came/Parkare	PKE	Copë	2	2022

7	Sistemi i leximit te targave	Came/Parkare	QUERCUS	Copë	6	2022
---	------------------------------	--------------	---------	------	---	------

Nr.	Emri i Pajisjes	Njësia	Sasia
1	Kasa Manuale	Copë	10
2	Terminali Hyrjes	Copë	11
3	Terminali i Daljes	Copë	11
4	Barrierat	Copë	22
5	Serveri	Copë	10
6	Tabela Treguese e vendeve	Copë	10
7	Sistemi i leximit te targave	Copë	22
8	Pistonat Oliodinamike	Copë	7
9	Kasa Automatike	Copë	3

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar)

Autoriteti Kontraktor Tirana Parking ka ndër të tjera, një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj, mirëmbajtjen e sistemeve të parkimit Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo edhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tijësaj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose

shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.